



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 qershor 2022
Nr. ref.:RK2006/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI16/22

Parashtrues

Hamit Gashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit
të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme AC-I-18-0160
të 29 shtatorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hamit Gashi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) përfaqësuar nga Cenë Gashi, avokat nga Klina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), AC-I-18-0160 të 29 shtatorit 2021.
3. Parashtruesi i kërkesës e pranoi Aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së më 1 tetor 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 31 janar 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 2 shkurt 2022, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi një dokument shtesë prej trembëdhjetë (13) faqesh që përfshin aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-I-18-0160 të 29 shtatorit 2021.
8. Më 3 shkurt 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, kryesuese, Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi.
9. Më 14 shkurt 2022, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe një kopje iu dërgua DHPGJS-së me ç'rast të njëjtës iu kërkuar që të dorëzojë dëshminë që vërteton datën kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar.
10. Më 21 shkurt 2022, DHPGJS-ja dorëzoi fletë-kthesën që dëshmon se parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 1 tetor 2021.
11. Më 11 maj 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte qenë i punësuar në NSH “Malishgan” Klinë prej datës 11.06.1988, në punë dhe detyra të punës teknik i bujqësisë ndërsa marrëdhënia e punës i ishte shkëputur më 26.09.1991.
13. Më 23 korrik 2007, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Klinë lidhur me konfirmimin e marrëdhënies së punës dhe kompensimin e të ardhurave personale në vlerë prej 21,390.00 euro. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata Komunale në Klinë që padinë e tij ta aprovoj të bazuar dhe ta obligoj të paditurën NSH “Malishgan” Klinë, që parashtruesit të kërkesës t’ia konfirmoj marrëdhënien e punës dhe t’ia kompensoj të ardhurat personale që nga 26.09.1991 (kur edhe i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës) deri më 15.07.1999, respektivisht, për nëntëdhjetetë (93) muaj nga 230 euro, në vlerë të tërësishme prej 21.390,00 euro, me kamatë si në mjete të deponuara në bankë, prej 26.09.1991, prej kur e paditura ka rënë në vonesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.
14. Më 20 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Klinë përmes Aktvendimit C.nr.102/07 shpallet jo-kompetente në çështjen juridike për konfirmim të marrëdhënies së punës dhe kompensim të të ardhurave personale sipas padisë së parashtruesit të kërkesës kundër të paditurës NSH “MALISHGAN” në Klinë. Lënda me të gjitha shkresat i përcillet DHPGJS-së, për shqyrtim dhe vendosje, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.
15. Më 24 dhjetor 2012, Gjykata Komunale në Klinë e përcolli lëndën së bashku me të gjitha shkresat në kompetencë të DHPGJS-së.
16. Më 4 dhjetor 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së përmes Aktvendimit C-II.-12-0041-C0001, vendosi: **(i)** Procedura në këtë çështje juridike pezullohet, për arsye se NSH “Malishgan” Klinë është në likuidim; **(ii)** Pezullimi do të mbetet në fuqi deri sa të nxjerret një vendim tjetër gjyqësor për shfuqizimin e pezullimit. Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme konstatoi se në pajtim me nenin 10.1.2 i Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, procedura gjyqësore kundër NSH “Malishgan” pezullohet sepse është subjekt i Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidim. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e këshilloi parashtruesin e kërkesës që padinë e tij ta adresoj tek Autoriteti për Likuidim për këtë ndërmarrje.
17. Më 6 gusht 2015, Autoriteti i Likuidimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit përmes Vendimit PEJ172-0055, vendosi që kërkesa e parashtruesit të kërkesës për kompensim të pagave të papaguara në shumë prej 21,390.00 euro për periudhën prej 26.09.1991 e deri më 01.07.1999 nga NSH “Malishgan” Klinë refuzohet e pavlefshme. Autoriteti i Likuidimit konstatoi: **(i)** nuk ka asnjë provë përpara këtij Autoriteti të Likuidimit që parashtruesi ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër deri më 26.09.1994; **(ii)** neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, parashikon që “pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që

rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet.”; **(iii)** të gjitha kërkesat për paga parashtruesi i kërkesës është dashur t’i dorëzojë më së voni deri më 26.09.1994, pra, 3 vite nga momenti që parashtruesi pretendon se nuk është paguar nga NSH-ja; **(iv)** rrjedhimisht, të gjitha kërkesat për pagat e papaguara që dorëzohen pas kësaj date janë të parashkruara dhe si të tilla të pavlefshme.

18. Më 15 shkurt 2018, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së përmes Aktgjykimit C-II-15-0360, refuzoi të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin ligjor: **(i)** me nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, kërkesa e parashtruesit të kërkesës arrin afatin e parashkrimit brenda tri (3) viteve; **(iii)** po ashtu, neni 87 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212 e parasheh afatin e njëjtë për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës; **(iv)** kërkesa për pagat e papaguara është parashtruar tek Autoriteti i Likuidimit dhe shumat nuk ishin kërkuar asnjëherë më parë; **(v)** skadimi përfundimtar i afatit të parashkrimit lidhur me shumat e kërkuara është 1 korrik 2002; **(vi)** padia e parashtruesit të kërkesës në tërësi është e pabazuar pasi që është e parashkruar; **(vii)** afati i parashkrimit nuk është ndërprerë dhe për këtë parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë dëshmi.
19. Më 15 mars 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë në DHPGJS. Parashtruesi i kërkesës pretendoi vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të dispozitave relevante ligjore. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar abrogimin e aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të pabazuar, si dhe të detyrohet Autoriteti i Likuidimit të NSH “Malishgan” që ta radhitë në listën e kreditorëve dhe që parashtruesit të kërkesës t’ia kompensojë dëmin në vlerë prej 21.390,00 euro për periudhën prej 26 shtator 1991 deri më 1 shtator 1999, me kamatë si për mjetet e afatizuara në banka që nga data 12 shtator 1991 që kur e paditura NSH “Malishgan” Klinë, ka rënë në vonesë deri në pagesën definitive.
20. AKP-ja parashtroi përgjigje në ankesë në DHPGJS në të cilën kishte theksuar se aktgjykimi i ankimuar është i bazuar në ligj e prova si i tillë duhet të vërtetohet. AKP-ja kërkoi nga DHPGJS-ja që ta refuzojë ankesën si të pabazuar dhe ta vërtetojë aktgjykimin e ankimuar.
21. Nga shkresat e lëndës rrjedh se më 18 maj 2018, Kryesuesi i Kolegji i Apelit të DHPGJS-së përmes Aktvendimit AC-I-18-0160 e liroi parashtruesin e kërkesës nga obligimi i pagesës së taksës gjyqësore, ndërsa, më 26 dhjetor 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktvendimit AC-I-15-0040, konstatoi: **(i)** ankesa e parashtruesit të kërkesës e paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar C-II-12-0041 i 4 dhjetorit 2014, konsiderohet e tërhequr; **(ii)** asnjëra palë nuk ka të drejtë në rimbursimin e shpenzimeve procedurale.
22. Ndërkohë, përkatësisht më 21 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi parashtrësë për informim me urgjencë në DHPGJS duke kërkuar që të informohet për procedurën dhe mbarëvajtjen e lëndës bazuar në ankesën e tij.
23. Më 29 shtator 2021, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së përmes Aktgjykimit AC-I-18-0160, konstatoi: **(i)** ankesa e parashtruesit të kërkesës refuzohet e pabazuar; **(ii)** vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-II-15-0360 i 15

shkurtit 2018; **(iii)** nuk caktohen taksa për procedurën gjyqësore. Kolegji i Apelit të DHPGJS-së në lidhje taksat gjyqësore theksoi se Kryesuesi i Kolegjit të Apelit përmes Aktvendimit AC-I-18-0160 e ka liruar parashtruesin e kërkesës nga obligimi i pagesës së taksës gjyqësore, prandaj, i njëjti nuk ngarkohet me taksë gjyqësore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
25. Parashtruesit e kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar janë cenuar parimi i kontradiktoritetit si dhe i barazisë së armëve në procedurë dhe parimi i sigurisë juridike lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar.
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se parimi i kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve janë shkelur për shkak se atij nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet, përkatësisht i është pamundësuar dhe mohuar e drejta e paraqitjes së provave dhe kundër-argumenteve për një vlerësim të gjithanshëm dhe objektiv.
27. Lidhur me të drejtën për siguri juridike, të drejtën për vendim të arsyetuar dhe të drejtën për dëgjim publik, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Shkelja e parimit për siguri juridike lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor ekziston për faktin se aktgjykimi i kontestuar është arbitrar, sepse shkel parimin e sigurisë juridike, i njëjti në arsyetimin e vendimit të kontestuar nuk thekson asnjë arsyetim për procedurën e iniciuar nga paditësi para luftës, ndërkaq procedura e filluar pas përfundimit të luftës në Kosovë, pranë Gjykatës Komunale në Klinë, është vazhdim i procedurës së paraluftës, me të njëjtën përmbajtje dhe kërkesë kundër të njëjtit subjekt juridik, e cila procedurë e iniciuar para luftës asnjëherë nuk ka përfunduar me vendim të plotfuqishëm. Ndaj mangësia totale e arsyetimit të aktgjykimit të kontestuar është veprim kundër kushtetues. Përveç kësaj nga parashtrimi i padisë në Gjykatën Komunale në Klinë, prej vitit 2007 e deri në marrjen e aktgjykimit të fundit të kontestuar nuk është mbajtur asnjë shqyrtim publik, përveç komunikimit shkresor që është në kundërshtim me parimin për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe objektiv, i garantuar me norma kushtetuese dhe instrumente juridike ndërkombëtare.”*
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Pse Gjykata asnjëherë nuk kërkoi raport me shkrim as nga Gjykata e Qarkut në Pejë, as nga Gjykata Komunale në Klinë, e as nga arkivi i ish Gjykatës së Punës së Bashkuar në Gjakovë, sepse cilëndo Gjykatë do t'i raportonin pa hezitim, ndërsa ankuesin fatkeqësisht askush nuk e ka marrë në konsideratë, përkundër kërkesave të vazhdueshme për të marrë informacion me shkrim për ecurinë dhe stadin e procedurës [...] Padia e ankuesit C.nr.102/07, dt. 23.03.2007 është dashur të konfirmohet me një vendim të gjykatës kompetente për përtëritjen e shkresave të lëndës, në mënyrë që ankuesi ti trajtonte kërkesat e tij para gjykatës, por kjo nuk ka ndodhur për 14 vite.”*

29. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës përmend se si DHPGJS-ja në disa raste tjera kishte vendosur që *“dosja e lëndës së bashku me kërkesën për përtëritjen e shkresave i përcjellët Gjykatës Themelore në Pejë.”* Parashtruesi i kërkesës shton: *“Të gjitha këto me të vetmin qëllim të trajtimit dhe shqyrtimit publik, për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe publik.”*
30. Lidhur me ndalimin e diskriminimit, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me AKP-në, në aktgjykimet e saj, për të satën herë ka konfirmuar se: “punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, ashkali, romë, egjiptian, turq, që kanë qenë të diskriminuar mbi baza etnike, për shkak të largimit masovik nga puna, pas aplikimit të masave të dhunshme në ndërmarrjet shoqërore në vitet e 90-ta nga organet e regjimit serb. Në këtë kuptim edhe ankuesi Hamit Gashi, ka qenë viktimë e largimit nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përkatësisë etnike, i njëjti ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të brendshme, pastaj i është drejtuar Gjykatës së Punës së Bashkuar në Gjakovë, pastaj lënda me ankesë ka shkuar në Gjykatën e Qarkut në Pejë, e cila procedurë asnjëherë nuk ka përfunduar me vendim të plotfuqishëm të gjykatës, për shkak të rrethanave të luftës, influencës së politikës në gjykatë, por ankuesi, për herë të dytë viktimizohet edhe me aktgjykimin e kontestuar, me të cilin haptas i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, KEDNJ dhe ligjin kundër diskriminimit.”*
31. Parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata: (i) ta shpall kërkesën të pranueshme, (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (iii) ta shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së AC-I-18-0160 të 29 shtatorit 2021 si dhe aktgjykimet e instancave më të ulëta.

Dispozitat ligjore relevante

SHTOJCA E LIGJIT Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 10 Pezullimi i veprimeve

1. Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Ky njoftim i referohet këtij neni 10 dhe shoqërohet me një kopje të Vendimit për Likuidim dhe një kopje të Njoftimit të publikuar për likuidim.

2. Veprimet, procedurat apo aktet e tilla të pezulluara mund të vazhdojnë apo të jenë në fuqi vetëm me leje të Autoritetit të likuidimit apo të Gjykatës. Këto veprime, procedura dhe akte përfshijnë mes tjerash, çdo veprim, procedurë apo akt:

2.1.që ka të bëjë me grumbullimin, kthimin apo zbatimin e Kërkesave për borxhe, taksa, gjoba apo obligime të çfarëdo lloji;

2.2.që ka të bëjë me krijimin, pranimin, modifikimin, rritjen, përmbushjen, regjistrimin apo zbatimin e çdo Kërkese apo Interesi kundrejt Ndërmarrjes apo çdo aset të ndërmarrjes;

2.3.çdo akt për realizimin, marrjen nën kontroll apo shitjen e aseteve të lëna peng, të hipotekuara apo që me çdo formë tjetër barre, apo ushtrimi i kontrollit mbi çdo aset të ndërmarrjes; dhe

2.4.procedurat apo veprimet rregullative që kanë të bëjnë me parandalimin apo korrigjimin e shkeljeve të dispozitave rregullative, rregullave apo vendimeve përderisa ato kanë të bëjnë me pretendime monetare ndaj ndërmarrjes.

LIGJI I PUNËS Nr. 03/L-212

Neni 87 Afati i parashkrimit

Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

34. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve, 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

35. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar se konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së [AC-I-18-0160] të 29 shtator 2021, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
36. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

37. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KIO4/21, *Parashtruese Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin KI175/21, *Parashtruese Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

38. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284, shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 38).
39. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
40. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlidhet me padinë që parashtruesi i kërkesës e kishte paraqitur në Gjykatën Komunale në Klinë lidhur me konfirmimin e marrëdhënies së punës dhe kompensimin e të ardhurave personale në vlerë prej 21,390.00 euro ta aprovoj të bazuar dhe ta obligoj të paditurën NSH “Malishgan” Klinë, që parashtruesit të kërkesës t’ia konfirmoj marrëdhënien e punës dhe t’ia kompensoj të ardhurat personale që nga 26.09.1991 deri më 15.07.1999. Gjykata Komunale në Klinë shpallet inkompetente në çështjen juridike të parashtruesit të kërkesës dhe lënda me të gjitha shkresat i përcillet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së vendosi që procedura në këtë çështje juridike pezullohet, për arsye se NSH “Malishgan” Klinë është në likuidim sepse është subjekt i Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidim. Autoriteti i Likuidimit vendosi që kërkesa e parashtruesit të kërkesës për kompensim të pagave të papaguara të refuzohet e pavlefshme sepse është parashkruar. Parashtruesi i kërkesës e kontestoi vendimin dhe kërkoi që të detyrohet Autoriteti i Likuidimit të NSH “Malishgan” që parashtruesin e kërkesës ta radhitë në listën e kreditorëve dhe që t’ia kompensojë dëmin në vlerë prej 21.390,00 euro për periudhën prej 26 shtator 1991 deri më 1 shtator 1999. Kolegji i Apelit të DHPGJS-së konstatoi se ankesa e parashtruesit të kërkesës refuzohet e pabazuar, vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe se nuk caktohen taksa për procedurën gjyqësore. Kolegji i Apelit të DHPGJS-së shpjegoi se afati i parashkrimit nuk është ndërprerë dhe për këtë

parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë dëshmi brenda tri viteve prej momentit kur e paditura nuk e ka përmbushur obligimin, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

41. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm me aktgjykimin e kontestuar janë shkelur e drejta për dëgjim publik, parimi i kontradiktoritetit, parimi i barazisë së armëve në procedurë dhe parimi i sigurisë juridike lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se ka qenë i diskriminuar nga vendimet që janë nxjerrë në procedurën e zhvilluar pranë DHPGJS-së dhe se DHPGJS-ja është dashur “të ripërtërijë dosjen e lëndës” nga gjykatat me “qëllim të trajtimit dhe shqyrtimit publik, për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe publik.”

Pretendimi për shkelje të së drejtës për dëgjim publik dhe siguri juridike siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 (1) të KEDNJ-së

42. Gjykata vëren se nga shkresat e lëndës përkatësisht (shih parashtresën e 15 marsit 2018 që parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së), nuk rezulton se pretendimet për shkelje të së drejtës për dëgjim publik dhe për siguri juridike janë ngritur në procedurat e zhvilluara në DHPGJS. Këto pretendime janë ngritur për herë të parë në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata thekson se në pajtim me parimin e subsidiaritetit, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta vlerësojë një pretendim apo një çështje që nuk është ngritur dhe vlerësuar paraprakisht nga gjykatat e rregullta (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KI89/15, *Parashtrues Fatmir Koci*, aktvendim për papranueshmëri i 22 marsit 2016, paragrafi 35).
43. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat pranë gjykatave të rregullta, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo të korrigjohen shkeljet e tilla pasi ato të kenë ndodhur. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë mundësitë në procedurat pranë gjykatave të rregullta (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese Nr. KIO1/19, *Parashtrues Fatos Rizvanolli*, aktvendim për papranueshmëri i 2 shtatorit 2020, paragrafi 99; dhe nr. KI24/16, *Parashtrues Avdi Haziri*, aktvendim për papranueshmëri i 16 nëntorit 2016, paragrafi 39 dhe referencat e përmendura aty).
44. Veç kësaj, Gjykata vëren se në praktikën gjyqësore të konsoliduar të GJEDNJ-së, parashtruesit nuk lirohen nga obligimi për ngritje të çështjeve tek gjykatat vendore, madje edhe në rastet kur gjykatat vendore kanë mundësi, apo janë të obliguara, ta shqyrtojnë rastin me vetë-iniciativë (*own motion*) në kuadër të të drejtave të mbrojtura me KEDNJ (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van Oosterwijk kundër Belgjikës*, aktgjykim lidhur me mos shterim të mjeteve juridike, i 6 nëntorit 1980 dhe *Gaziyev kundër Azerbaixhanit*, Vendim i Pjesshëm për Pranueshmëri, i 8 shkurtit 2007).
45. Rrjedhimisht, këto pretendime shpallen të papranueshme për shkak të mos shterjes në substancë të mjeteve juridike në procedurën e zhvilluar pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.

Pretendimi për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 (1) të KEDNJ-së

46. Në këtë drejtim, Gjykata vë në spikamë konstatimet e Kolegji të Apelit të DHPGJS-së: **(i)** Kolegji i Apelit vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka kërkuar nga NSH-ja borxhin në fjalë nga momenti kur e paditura nuk e përmbushur detyrimin e vet, as edhe ndaj ndonjë organi tjetër kompetent, me qëllim të konfirmimit, garantimit apo realizmit të kërkesës së tillë; **(ii)** nga padia e parashtruesit të kërkesës shihet se paga e fundit e kërkuar nga NSH-ja është e muajit korrik 1999; **(iii)** paga e fundit e kësaj periudhe është parashkruar më 1 korrik 2002, ndërsa edhe pagat tjera më herët, në bazë të Ligjit për Punën e Bashkuar të vitit 1974, janë parashkruar; **(iv)** në bazë të nenit 42 paragrafi 2 të Ligjit për DHPGJS-në, barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e kërkesës; **(v)** parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të provojë se ka ankimuar vendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës duke paraqitur padi në gjykatë; **(vi)** afati i parashkrimit nuk është ndërprerë dhe për këtë parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë dëshmi brenda tri viteve prej momentit kur e paditura nuk e ka përmbushur obligimin, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar; **(vii)** nga arsyet e cekura, ankesa e parashtruesit të kërkesës refuzohet e pabazuar dhe vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
47. Gjykata vlerëson se Kolegji i Apelit sikurse Kolegji i Specializuar të DHPGJS-së por edhe Autoriteti i Likuidimit kanë shpjeguar qartësisht faktin se parashtruesi i kërkesës në dy instanca ka humbur të drejtën për të kërkuar kompensimin e pagave: **(i)** instanca e parë ndërlihet me parashkrimin e kërkesës më 26.09.1994 bazuar në ligjin atëbotë të aplikueshëm përkatësisht nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976); **(ii)** instanca e dytë ndërlihet me parashkrimin e kërkesës më 1 korrik 2002 bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.
48. Gjykata dhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e tyre kanë theksuar se neni 31 i Kushtetutës përkatësisht neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, obligon gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, ato gjithashtu kanë konstatuar se kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. (Shih rastet e Gjykatës nr. KI174/21 *Parashtrues Bashkim Makiqi*, aktvendim për papranueshmëri i 16 shkurtit 2022, paragrafi 57 dhe nr. KI97/16 *Parashtrues IKK Classic*, aktgjykim i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 49 dhe po ashtu shih rastet e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42).
49. Gjykata vlerëson se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së është i arsyetuar dhe përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (shih rastet e Gjykatës, nr. KI174/21 *Parashtrues Bashkim Makiqi*, cituar më lart, paragrafi 58 dhe nr. KI72/12, *Parashtrues Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, aktgjykim i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61, dhe nr. KI135/14, *IKK Classic*, aktgjykim i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58).

50. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i vërtetimit të gabuar të fakteve dhe interpretimit të gabuar të ligjit, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se procedurat para DHPGJS-së, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se DHPGJS-ja ka marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar të njëjtat (Shih në këtë kontekst, rastet e Gjykatës, nr. KI174/21 *Parashtrues Bashkim Makiqi*, cituar më lart, paragrafi 59 dhe nr. KI64/20, *Parashtruesi Asllan Meka*, aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41, dhe KI22/19, *Parashtrues Sabit Ilazi*, aktvendim për papranueshmëri i 8 majit 2019, paragrafi 43).
51. Gjykata konkludon se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 (1) të KEDNJ-së është pretendim që kualifikohet si pretendim i “shkallës së katërt” dhe si i tillë, ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Pretendimi për shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 (1) të KEDNJ-së

52. Gjykata ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës nr. KI215/21 *Parashtrues Arbër Shkreli dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 90; nr. KI128/18 *Parashtrues Limak Kosovo International Airport Sh.A. “Adem Jashari”*, aktvendim për papranueshmëri i 27 majit 2019, paragrafi 56; dhe KI62/19 *Parashtrues Gani Gashi*, aktvendim për papranueshmëri i 13 nëntorit 2019, paragrafi 58).
53. Duke vlerësuar procedurat e zhvilluara në tërësi në gjykatat e rregullta, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës përfitoi nga procedura kontradiktore dhe se ai ishte në gjendje të paraqes në faza të ndryshme të procedurës pretendimet dhe provat që ai i konsideroi të rëndësishme për rastin e tij; ai ka pasur mundësinë të hedh poshtë në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta dëgjuan dhe shqyrtuan të gjitha pretendimet e tij, të cilat, shikuar objektivisht, ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit; arsyet faktike dhe ligjore për vendimin e kontestuar janë dhënë në hollësi dhe procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më

lart, paragrafët 29 dhe 30, shih gjithashtu rastet e Gjykatës nr. KI215/21 *Parashtrues Arbër Shkreli dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 91; nr. KI22/19, *Parashtrues Sabit Ilazi*, aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rasti KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).

54. Gjykata konkludon se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 (1) të KEDNJ-së është pretendim që kualifikohet si pretendim i “*shkallës së katërt*” dhe si i tillë, ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Pretendimi për shkelje të parimit për ndalim të diskriminimit

55. Lidhur me pretendimin për shkelje të parimit për mos diskriminim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon: “*Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me AKP-në, në aktgjykimet e saj, për të satën herë ka konfirmuar se: “punëtorët e përkatësisë etnike shqiptare, ashkali, romë, egjiptian, turq, që kanë qenë të diskriminuar mbi baza etnike, për shkak të largimit masovik nga puna, pas aplikimit të masave të dhunshme në ndërmarrjet shoqërore në vitet e 90-ta nga organet e regjimit serb. Në këtë kuptim edhe ankuesi Hamit Gashi, ka qenë viktimë e largimit nga marrëdhënia e punës mbi bazën e përkatësisë etnike, i njëjti ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të brendshme, pastaj i është drejtuar Gjykatës së Punës së Bashkuar në Gjakovë, pastaj lënda me ankesë ka shkuar në Gjykatën e Qarkut në Pejë, e cila procedurë asnjëherë nuk ka përfunduar me vendim të plotfuqishëm të gjykatës, për shkak të rrethanave të luftës, influencës së politikës në gjykatë, por ankuesi, për herë të dytë viktimizohet edhe me aktgjykimin e kontestuar, me të cilin haptas i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, KEDNJ dhe ligjin kundër diskriminimit.”*
56. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për ndalim të diskriminimit, Gjykata vëren se bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ-së në mënyrë që një çështje të ngrehet nën nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] aty duhet të ketë dallim në trajtim të personave në situata analoge ose që janë në mënyrë relevante të krahasueshme (shih, mes shumë autoritetesh tjera, *Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Rosisë*, Aktgjykim 2017 paragrafi 64; *X dhe të tjerët kundër Austrisë*, Aktgjykim 2013, paragrafi 98; dhe *Konstantin Markin kundër Rosisë*, Aktgjykim 2012, paragrafi 125). Me fjalë të tjera, kriteri për demonstrimin e pozitës analoge nuk kërkon që grupet e krahasuara (*comparator groups*) të jenë identike. Një parashtrues duhet të demonstrojë, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të ankesës së tij apo të saj, që ai ose ajo ka qenë në një situatë që në mënyrë relevante është e krahasueshme (*relevantly similar situation*) me të tjerët që janë trajtuar ndryshe (shih *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim 2010, paragrafi 66). Megjithatë, jo çdo dallim në trajtim rezulton me shkelje të nenit 14. Së pari, GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka përcaktuar se vetëm dallimi në trajtim bazuar në karakteristika të identifikueshme, ose “status”, janë në gjendje të rezultojnë me diskriminim në kuadër të nenit 14 (shih *Carson dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 61, dhe *Eëeida dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.

48420/10, paragrafi 86, Aktgjykim 2013). Së dyti, dallimi në trajtim është diskriminues nëse nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm; thënë ndryshe, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ka marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih rastin e Gjykatës nr. KI215/21 Parashtrues *Arbër Shkreli dhe të tjerët*, aktvendim për papranueshmëri i 15 shkurtit 2022, paragrafi 87 dhe rastet e GJEDNJ-së *Fabris kundër Francës* Aktgjykim 2013, paragrafi 56; *Topčić-Rosenberg kundër Kroacisë*, Aktgjykim 2013, paragrafi 36; dhe *Ēeller kundër Hungarisë*, Aktgjykim 2009, paragrafi 27).

57. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar apo identifikuar individin apo grupin në krahasim me të cilin është diskriminuar dhe me të cilin ai ka qenë në një situatë që në mënyrë relevante është e krahasueshme. Barra e të provuarit për trajtim diskriminues bie mbi parashtruesin e kërkesës çka bazuar në shkresat e lëndës është evidente se pretendimin për diskriminim ai nuk e ka provuar. (shih rastin e Gjykatës nr. KI143/20, Parashtrues *Radovan Paunović*, Aktvendim për Papranueshmëri i 8 shtatorit 2021, paragrafët 54-55, dhe po ashtu shih rastet e GJEDNJ-së, *Khamtokhu dhe Aksenchik*, cituar më lart, paragrafi 65; *Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë*, Aktgjykim 2013, paragrafi 85; dhe *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim 2007, paragrafi 177).
58. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit për ndalim të diskriminimit, është pretendim që kualifikohet si pretendim i “*shkallës së katërt*” dhe si i tillë, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Pretendimi për “përtëritjen e shkresave të lëndës” nga DHPGJS-ja

59. Gjykata po ashtu vlerëson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për “*përtëritjen e shkresave të lëndës*” nga DHPGJS-ja është çështje e ligjshmërisë që bie në fushëveprimin e gjykatave të rregullta dhe, veç kësaj, nga shkresat e lëndës rezulton se më 24 dhjetor 2012 Gjykata Komunale në Klinë kishte përcjellë lëndën së bashku me të gjitha shkresat në kompetencë të DHPGJS-së.
60. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për “*përtëritjen e shkresave të lëndës*” është pretendim që kualifikohet si pretendim i “*shkallës së katërt*” dhe si i tillë, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 11 maj 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani